



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Tetor 2025

Data 27.10.2025 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 29.09.2025, si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shtator 2025.
- 3.Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 161.8 ha “Për park fotovoltai (stacionet, objektet përkatëse etj)” në ekonominë pyjore Gjader Mnelë.
- 4.Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 105.10 ha “Për park fotovoltai (stacionet, objektet përkatëse etj)” në ekonominë pyjore Gjader Mnelë..
- 5.Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 88.68 ha “Për park fotovoltai (stacionet, objektet përkatëse etj)” në ekonominë pyjore Gjader Mnelë.
- 6.Projekt vendim “Për plotësimin e vendimit nr.38 datë 24.05.2024 të K.B me çertifikatë pronësie me Nr.Pasurie 685/4, Zk.3506”
- 7.Projekt vendim për miratimin e ndryshimit të Vkb nr.21 datë 26.03.2025 dhe Vkb nr.33 datë 28.04.2023, Vkb nr.80 datë 30.10.2022 për ngritjen e komisionit të strehimit.
- 8.Projekt vendim për pranimin e të moshuarit Z.Mark Gjokaj në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar “Besa” Barbullush.
- 9.Projekt vendim për pranimin e të moshuarit Z.Agron Bajraktari në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar “Besa” Barbullush.
- 10.Projekt vendim për miratimin e planit zhvillimit të turizmit 2025-2030, të Bashkisë Vau Dejës.
- 11.Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.43 datë 29.08.2025, për ndryshimin e VKB nr.84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtarë 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.
- 12.Projekt vendim për ndryshimin e burimit të financimit për urdhër blerjen nr.30 datë 26.12.2024, nëpërmjet ndryshimit të Vkb nr.84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtarë 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

13.Raporti monitorimit për periudhen Janar-Gusht 2025 dhe vetëvlerësimi për situatën e gjendjes financiare Janar-Gusht 2025.

14.Të ndryshme.

Grupe interesi ishin prezent në mbledhje 4 banorë të fshatit Mnelë:Z.Ndue Bib Kola,Z.Pashk Gjon Nikolli,Z.Fran Ded Gjoni,Z.Anton Zef Pjetri.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 27.10.2025 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepja.Të pranishëm në sallë ishin 17 këshilltarë,(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Mirela Vasija, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Mark Bisha), korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Rendi i ditës u miratua me 17 vota Pro. Këshilltarët që votuan pro:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Mirela Vasija, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Mark Bisha).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 29.09.2025 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 29.09.2025 nga Z.Ervis Shimaj.Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarët që votuan pro:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Mirela Vasija, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Mark Bisha).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:



Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shtator 2025

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se projekt vendimi është hartuar bazuar ne ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Ajo shprehet se projekt vendimi propozon qe: Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Shtator 2025 , familje 134, me 426.347 lekë, me 5.98% e fondit total.

Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Shtator 2025 janë shpallur fitues, 899 familje, me fond 7.106.973 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 426.418 lekë.

Z.Ervis Shimaj spjegon se komisioni i K.Bashkiak ka propozuar miratimin e projekt vendimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 17 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Mirela Vasija, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Mark Bisha).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 161.8 ha “Për park fotovoltai (stacionet, objektet përkatëse etj)” në ekonominë pyjore Gjader Mnelë.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Zeqir Ujka-përgjegjës i zyres pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë Vau Dejës, i cili relaton për projekt vendimin dhe spjegon rrugët ligjore që janë ndjekur për hartimin e tij, si dhe të ardhurat që do të mblidhen nga dhënia në përdorim e kësaj sipërfaqe në favor të Bashkisë.Z.Zeqir Ujka spjegon se është haruar raporti tekniko ekonomik për dhënien në përdorim për park fotovoltai të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Vau Dejës, sipërfaqe të cilat janë të çertifikuara në emër të Bashkisë Vau Dejës.Z.Ujka sqaron se të drejten ligjore për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

të dhënë me qira apo përdorim të pronave të certifikuara në emër të bashkisë e ka Këshilli Bashkiak Pas miratimit në Këshill dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër, do të ndiqet rruga ligjore e nënshtrimit të procedurës së konkurrimit publik, ku gjatë periudhës së publikimit për konkurrim publik, mund të marrë pjesë kushdo dhe cilido që plotëson dokumentacionin. Pra sipërfaqja e sipërcituar do të nënshtrohet procedurës së konkurrimit publik.

Z. Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se nga ana e këshillit bashkiak, është ndjekur procedura e njoftimit për konsultim publik (megjithëse nuk është detyrim ligjor për rastet e dhënies së sipërfaqeve pyjore-kullosore me qira apo përdorim) me arsyen se çdo punë e këshillit të jetë sa më transparente me banorët në mënyrë që ato të vihen në dijeni për investimet që do bëhen në zonat ku ato banojnë. Njoftimi është bërë që me datë 25.09.2025 për realizimin e këtij takimi sensibilizues me datë 23.10.2025, ku ky njoftim është publikuar në faqen WEB të Bashkisë si dhe në vende të dukshme pranë Nj. A Vig Mnelë. Banorët e pranishëm në takimin me datë 23.10.2025, kanë shprehur dakortësi për projekt vendimet e paraqitura. Gjithashtu Z. Ervis Shimaj sqaron se është bërë një kërkesë-ankesë nga disa banorë të fshatit Mnelë, ku ato pretendojnë se nuk kanë qenë në dijeni të dëgjësës publike, por Z. Shimaj spjegon se njoftimi ka qenë i bërë publik që me datë 23.09.2025 dhe se është lehtësisht i verifikueshëm.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 17 vota Pro. zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e tretë të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj, Majlinda Ndrecaj, Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Mirela Vasija, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Mark Bisha).

Z. Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënie në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 105.10 ha “Për park fotovoltai (stacionet, objektet përkatëse etj)” në ekonominë pyjore Gjader Mnelë.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z. Zeqir Ujka-përgjegjës i zyrës pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë Vau Dejës, i cili relaton për projekt vendimin dhe spjegon rrugët ligjore që janë ndjekur për hartimin e tij, si dhe të ardhurat që do të mblidhen nga dhënia në përdorim e kësaj sipërfaqe në favor të Bashkisë. Z. Zeqir Ujka spjegon se është haruar raporti tekniko ekonomik për dhënie në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

përdorim për park fotovoltaike të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Vau Dejës, sipërfaqe të cilat janë të çertifikuara në emër të Bashkisë Vau Dejës. Z. Ujka sqaron se të drejten ligjore për të dhënë me qira apo përdorim të pronave të çertifikuara në emër të bashkisë e ka Këshilli Bashkiak Pas miratimit në Këshill dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër, do të ndiqet rruga ligjore e nënshtrimit të procedurës së konkurrimit publik, ku gjatë periudhës së publikimit për konkurrim publik, mund të marrë pjesë kushdo dhe cilido që plotëson dokumentacionin. Pra sipërfaqja e sipërcituar do të nënshtrohet procedurës së konkurrimit publik.

Z. Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se nga ana e këshillit bashkiak, është ndjekur procedura e njoftimit për konsultim publik (megjithëse nuk është detyrim ligjor për rastet e dhënies së sipërfaqeve pyjore-kullosore me qira apo përdorim) me arsyen se çdo punë e këshillit të jetë sa më transparente me banorët në mënyrë që ato të vihen në dijeni për investimet që do bëhen në zonat ku ato banojnë. Njoftimi është bërë që me datë 25.09.2025 për realizimin e këtij takimi sensibilizues me datë 23.10.2025, ku ky njoftim është publikuar në faqen WEB të Bashkisë si dhe në vende të dukshme pranë Nj. A Vig Mnelë. Banorët e pranishëm në takimin me datë 23.10.2025, kanë shprehur dakortësi për projekt vendimet e paraqitura.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 17 vota Pro, zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj, Majlinda Ndrecaj, Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Mirela Vasija, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Mark Bisha).

Në këtë moment bëhet pjesë e mbledhjes, këshilltari Z. Martin Mardoda, i cili kishte njoftuar paraprakisht për vonesën. Numri i këshilltarëve prezent bëhet 18.

Z. Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënie në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 88.68 ha “Për park fotovoltaike (stacionet, objektet përkatëse etj)” në ekonominë pyjore Gjader Mnelë.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z. Zeqir Ujka-përgjegjës i zyrës pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë Vau Dejës, i cili relaton për projekt vendimin dhe spjegon rrugët ligjore që janë ndjekur për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

hartimin e tij, si dhe të ardhurat që do të mblidhen nga dhënia në përdorim e kësaj sipërfaqe në favor të Bashkisë.Z.Zeqir Ujka spjegon se është haruar raporti tekniko ekonomik për dhënien në përdorim për park fotovoltaik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Vau Dejës, sipërfaqe të cilat janë të certifikuara në emër të Bashkisë Vau Dejës.Z.Ujka sqaron se të drejten ligjore për të dhënë me qira apo përdorim të pronave të certifikuara në emër të bashkisë e ka Këshilli BashkiakPas miratimit në Këshill dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër, do të ndiqet rruga ligjore e nënshtrimit të procedures së konkurrimit publik, ku gjatë periudhes së publikimit për konkurrim publik, mund të marrë pjesë kushdo dhe cilido që plotëson dokumentacionin.Pra sipërfaqja e sipërcituar do ti nenshtrohet procedures së konkurrimit publik.

Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se nga ana e këshillit bashkiak, është ndjekur procedura e njoftimit për konsultim publik (megjithëse nuk është detyrim ligjor për rastet e dhënies së sipërfaqeve pyjore-kullosore me qira apo përdorim) me arsyen se çdo punë e këshillit të jetë sa më transparente me banorët në mënyrë që ato të vihen në dijeni për investimet që do bëhen në zonat ku ato banojnë.Njoftimi është bërë që me datë 25.09.2025 për realizimin e këtij takimi sensibilizues me datë 23.10.2025, ku ky njoftim është publikuar në faqen WEB të Bashkisë si dhe në vende të dukshme pranë Nj.A Vig Mnelë.Banorët e pranishëm në takimin me datë 23.10.2025, kanë shprehur dakortësi për projekt vendimet e paraqitura.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e pestë të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Mirela Vasija, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Mark Bisha, Martin Mardoda).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:

Projekt vendim “Për plotësimin e vendimit nr.38 datë 24.05.2024 të K.B me certifikatë pronësie me Nr.Pasurie 685/4, Zk.3506”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Zeqir Ujka-përgjegjës i zyres pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë Vau Dejës, i cili relaton për projekt vendimin dhe spjegon se Institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër ka kërkuar që Vendimi nr.38 datë 24.05.2024, të plotësohet me çrtifikatë pronësie në emër të Bashkisë Vau Dejës për sipërfaqen që është vendosur nga K.B të jepet në përdorim dhe tani paraqesim projekt vendimin e plotësuar me çrtifikatë pronësie.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e gjashtë të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Mirela Vasija,Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Mark Bisha, Martin Mardoda).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e ndryshimit të Vkb nr.21 datë 26.03.2025 dhe Vkb nr.33 datë 28.04.2023,Vkb nr.80 datë 30.10.2022 për ngritjen e komisionit të strehimit.

Këshilltarja Znj.Mirela Vasija largohet nga mbledhja,numri i këshilltarëve prezent mbetet 17.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Dajana Lleshi- specialiste e zyres strehimit Bashkia Vau Dejës e cila relaton për projekt vendimin ku kërkohet zëvendësimi i një pjestari të komisionit të strehimit social për shkak të një largimi të një anëtari të mëparshëm.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 17 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e shtatë të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Mark Bisha, Martin Mardoda).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Projekt vendim për pranimin e të moshuarit Z.Mark Gjokaj në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar “Besa” Barbullush.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Marketa Lleshaj- specialiste pranë zyres ndihmes ekonomike dhe strehimit social e cila relatton për këshilltarët se është pregaditur projekt vendimi për pranimin e të moshuarit Z.Mark Gjokaj në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar “Besa” Barbullush, i cili është pa mbështetje familjare, i vetëm në gjendje të renduar ekonomike. Ambjentet ku jeton nuk i plotësojnë kushtet minimale të higjenes dhe komoditetit për jetesë të përshtatshme.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 17 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e tetë të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Mark Bisha, Martin Mardoda).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:

Projekt vendim për pranimin e të moshuarit Z.Agron Bajraktari në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar “Besa” Barbullush.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Marketa Lleshaj- specialiste pranë zyres ndihmes ekonomike dhe strehimit social e cila relatton për këshilltarët se është pregaditur projekt vendimi për pranimin e të moshuarit Z.Agron Bajraktari në qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar “Besa” Barbullush, i cili është shprehur se jeton prej disa vitesh tek të afërm të bashkëshortes pasi nuk ka familjare. Nuk ka të afërm të tjerë për tu përkujdesur për të. Gjatë kësaj periudhe ka jetuar tek të afërm, por e ka të pamundur të qëndrojë me gjatë për shkak të problematikave social-ekonomike. I gjendur në një situatë të tillë dhe pa mbështetje nga të afërmit kërkon që të sistemohet në një qendër të moshuarish pasi socializimi me të tjerë do bënte që të kalonte ditë më të qeta dhe më të lumtura.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 17 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e nëntë të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkja, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Mark Bisha, Martin Mardoda).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e dhjetë të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e planit zhvillimit të turizmit 2025-2030, të Bashkisë Vau Dejës.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Anton Pjetraj-specialist pranë zyres turizmit, Bashkia Vau Dejes, i cili relatton për projekt vendimin dhe spjegon në detaje hartimin e planit për zhvillimin e turizmit 2025-2030 si dhe hapat ligjorë që janë ndjekur për hartimin e tij. Bashkia Vau Dejës ka hartuar Planin e Zhvillimi të Turizmit Vendor 2025-2030. Hartimi i planit siguron një mbështetje të planifikuar të zhvillimit të turizmit me objektiva të qarta strategjike për periudhën 2025-2030 dhe me plane konkrete të ndërhyrjes në drejtim të përmirësimit të ofertës turistike, ndërhyrje infrastrukturore në shërbim të turizmit, përmirësimit të promovimit të burimeve turistike të zonës, duke përmbyshur detyrimet ligjore të Bashkisë.

Në hartimin e këtij Plani, Bashkia është mbështetur nga Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian "VAU DEJES si një Destinacion Turistik". Pas përgatitjes së draftit ai ka kaluar për konsultim publik në takime me komunitetin të organizuara në njësitë administrative në Hajmel dhe Bushat.

Këshilltari Z.Mark Bisha largohet nga mbledhja, numri i këshilltarëve prezent mbetet 16.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e dhjetë të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj, Majlinda Ndrecaj, Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Martin Mardoda).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.43 datë 29.08.2025, për ndryshimin e VKB nr.84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtarë 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës".

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elsa Tanushi-Drejtoresh e zyres Finance Buxhetit, Bashkia Vau Dejes e cila spjegon se duke u nisur nga shkresa Nr. 4120 Prot datë 24.07.2025 e Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Zhvillimit të Turizmit, Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit drejtuar Sektorit të Financës me lëndë "Kërkesë për Rishikim Buxheti viti 2025, viti 2026" jemi angazhuar me VKB nr.43 datë 29.08.2025 për të vënë në dispozicion vlerën e kërkuar për realizimin e projektit duke bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet programeve buxhetore.

Shkresa ka ardhur në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Vau-Dejës dhe FSHS-së, ku FSHF-ja është e angazhuar të bashkëfinancojë 50% të vlerës së investimit total prej 36,259,842.14 ALL. Nevoja për ndryshimin e VKB nr 43 datë 29.08.2025 ka ardhur për shkak se në këtë VKB kemi paksuar për vitin 2025 zërin e buxhetit "Sistemim dhe rrethim i fushes së sportit në shkollën



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Narac+Mbikqyrje+Kolaudim" dhe për vitin 2026 zërat e buxhetit "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të pa favorizuara+Mbikqyrje+Kolaudim"; "Rikonstruksion i godines kopesht per femije Vau Dejes" dhe "Sistemim asfaltim rruga Pistull-Hajmel+Mbikqyrje+Koludim" të cilët kanë rezultuar me pamjaftueshmëri fondesh. Në kete projekt vendim janë prekur zëra buxheti të investimeve që nuk janë pjesë e projekteve prioritare për vitin 2025, në zbatim të nenit 100 Rishperndarja e fondeve.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Martin Mardoda).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e burimit të financimit për urdhër blerjen nr.30 datë 26.12.2024, nëpërmjet ndryshimit të Vkb nr.84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtarë 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës"

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elsa Tanushi-Drejtores së zyrës Finance Buxhetit, Bashkia Vau Dejes e cila shpjegon se me datë 18.11.2024 është lidhur kontrata Nr.6122/18 me objekt "Blerje artikuj ushqimore për Konviktin Ndre Mjeda, Bushat", UB nr 30 datë 26.12.2024 me objekt kontrate "Blerje artikuj ushqimore për Konviktin Ndre Mjeda, Bushat" me vlerë prej 629,098 leke.

Në vijim të kësaj kontrate janë leshuar fatura nr 867/2024 datë 02.12.2024 fatura nr 964/2024 datë 26.12.2024 dhe fatura nr 966/2024 datë 26.12.2024.

Fondi sipas UB nr 30 datë, është me burim financimi Ministri 12, kod projekti 91209AB.

Ky fond është çelur në buxhet po jo CASH nga ana e Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Megjithatë ky fond ka patur afat shpenzimi brenda vitit 2024, kjo kontrate ka mbetur e palikuiduar, saktësisht faturat nr nr 867/2024 datë 02.12.2024; fatura nr 964/2024 datë 26.12.2024 dhe fatura nr 966/2024 datë 26.12.2024, për mungesë fonde cash.Shkresa e fundit dërguar nga MEKI, Nr. 10598/1 prot, datë 15.08.2025 na informon që nuk do kete përcjelle fondesh nga Ministria për kete UB, konsideruar që është një UB e vitit 2024, dhe nuk mbarten ndër vite fonde për kete kategori shpenzimesh.

Ndodhur në keto kushte nëpërmjet këtij projekt vendimi jemi angazhuar për përballimin e këtij shpenzimi, me fondet e Bashkisë, duke bërë ndryshimet përkatëse sipas tabelës bashkangjitur, pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:



Miratohet me 16 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim. Këshilltarët që votuan Pro piken e dymbëdhjetë të rendit të ditës:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Martin Mardoda).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e trembëdhjetë të rendit të ditës:

Raporti monitorimit për periudhen Janar-Gusht 2025 dhe vetëvlerësimi për situatën e gjendjes financiare Janar-Gusht 2025.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elsa Tanushi-Drejtoreshë e zyrës Finance Buxhetit, Bashkia Vau Dejës e cila shpjegon se jeni të pajisur me materialin e gjendjes financiare të Bashkisë për periudhën Janar-Gusht 2025 dhe në mënyrë të koncentruar e rëndësishme është se Bashkia gjatë kësaj periudhe ka ecuri të mirë lidhur me mbledhjen e të ardhurave.Shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë 8 mujore janë realizuar.Janë zbritur detyrimet e fundvitit 2024 dhe të gjitha këto të dhëna tregojnë se Bashkia ka një situatë të qëndrueshme ekonomiko financiare.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime lidhur me raportin e monitorimit dhe vetëvlerësimit ekonomiko financiarë për periudhën 8 muaj Janar-Gusht 2025.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Raporti miratohet në unanimitet të plotë me 16 vota pro. Këshilltarët që votuan raportin e monitorimit dhe vetëvlerësimit financiarë:(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Meliha Zyberaj,Majlinda Ndrecaj,Leonora Prenga, Rita Preçi, Neki Kapllanaj, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Arsen Mehmeti, Albina Livadhi, Edona Molla, Roberto Trushi, Besmir Kapaj, Sanije Salja, Martin Mardoda).

Pika 14 Të ndryshme.

Z.Martin Mardoda ngre shqetësimin lidhur me argjinturën në Naraç e cila paraqitet problematike sidomos në rastin e reshjeve të shumta këto ditë.Duhet të ndërhyhet me mirembajtje.

Z.Ervis Preçi-Zv kryetar Bashkie-Do të verifikohet dhe do ju kërkohet institucioneve qeveritare që të ndërhyhet.

Znj.Saniye Salja-Te lagja Correjve duhet të pastrohet kanali sepse krijon problem në rrugë kur ka reshje.

Z.Ervis Preçi-Zv kryetar Bashkie-Do të verifikohet dhe do të ndërhyhet nga ana e Bashkisë për zgjidhjen e këtij problemi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhja e Këshillit Bashkiak e datës 27.10.2025, deklarohet e mbyllur nga Kryetari Këshillit, pasi nuk kishte pyetje apo diskutime tjera.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

1. Enver Shiuq
2. Fano Prenga
3. Melita Gjergj
4. Kujtimë Doku
5. Leonora Prenga
6. Prita Prenga
7. Neli Kapllan
8. Ermin Tahiri
9. Kostriot Shkë
10. Arsen Mehmeti
11. Allina Liva
12. Mirela Vasiq
13. Edona Molla
14. Robert Trani
15. Dennis Kopy

16. Vangjel Saji
17. Mark Bish
18. Martin Marabolat
19. _____
20. _____
21. _____
22. _____
23. _____
24. _____
25. _____
26. _____
27. _____
28. _____
29. _____
30. _____
31. _____